



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 639/25 Dt. 08.12.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b, d dhe g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të ardhur nga aplikantët të cilët kanë aplikuar në bazë të thirrjes për projektin: “Shtëpizat e Drurit–Dimri Kulturor”. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Vetan Xhemaj,..... kryesues,
 - 1.2. Agnesa Thaqi Kurejshi,anëtare,
 - 1.3. Halil Lika,.....anëtar,
 - 1.4. Blerim Rakaj,.....anëtar rezervë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi janë: të shqyrtoj, vlerësoj dhe vendos për të gjitha ankesat e ardhura nga aplikantët të cilët kanë aplikuar në bazë të thirrjes për projektin: “Shtëpizat e Drurit–Dimri Kulturor”, konform thirrjes publike 12-332-156192, datë 01.12.2025, dhe të njëjtit nuk janë shpallur fitues nga ana e Komisionit që ka bërë vlerësimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve konform thirrjes së lartcekur.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
4. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Komisioni i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - Komisionit të lartcekur,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

